



**KUVENDI I KOMUNËS–SUHAREKË
SKUPŠTINA OPSTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA**



PROCESVERBAL III/2022

**I mbajtur me rastin e mbledhjes së 3 (tretë) për vitin 2022 të Kuvendit të
Komunës së Suharekës**

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 30.03.2022
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci	Z. Xhevhet Gashi	Të pranishëm të tjerë
Z.Selman Kolgeci	Z.Edon Sadikaj	Kryetari Komunës
Z. Flamur Bytyqi	Z.Dardan Berisha	
Z. Urim Suka	Z.Bajram Basha	Media dhe qytetarë
Z. Kushtrim Kuçi	Znj.Mevlude Kabashi	OSCE, LMT, KDI
Znj. Elmaze Bytyqi	Znj.Sheqerije Zyrapi	Znj.Habibe Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi	Znj.Laureta Tafaj	Z.Xheladin Sadikaj
Znj.Doruntina Zenelaj	Z.Liridon Fandaj	
Z.Alban Berisha	Z.Qëndrim Elshani	
Z. Bexhet Kuçi	Znj.Festë Kabashi	
Z. Reshat Selimaj	Z.Herolind Limaj	
Z. Lirim Qatani	Znj. Jehona Rrafshi	
Z. Aziz Bytyqi		
Znj.Sanie Kuçi-		
Rexhepaj		
Znj.Mimoza Bajraktari		
Znj.Fidaije Kukaj		
Znj. Afërdita Morina		
Znj.Saranda Bajraktari		
Z. Driton Maliqaj		

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi .

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-projekt vendimit për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomikë Lokal;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2021,të komisionit komunal të aksionarëve të NPL“Stacioni i Autobusëve“ SH.A.;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 5. Shqyrtim i projekt-vendimt për për fillimin e nismës së procedurës për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit „Harta Zonale e Komunës 2022-2030“;**
- 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2021;**
- 8. Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit.Para se të hedh rendin e ditës në votim,kërkoj që pika e katër të largohet nga rendi i ditës.Për sqarime është i pranishën drejtori i Kadastrit.

Urim Suka - kërkoj sqarime.

Armend Krasniqi - në mungesë të dokumentacionit ne kemi konstatu që pika 4 të mos jetë në rend dite.

Flamur Bytyqi - kërkoj më shumë sqarime sepse kjo nuk është e mjaftueshme.

Kryesuesi - e hedh në votim që pika 4 të largohet nga rendi i ditës.

Unanimisht Miratohet

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës pa pikën 4.

Unanimisht Miratohet

Pika1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - a keni vërejtje në nprocesverbal?

Urim Suka - ky procesverbal i mbledhjes së fundit është kogja i cungun.Gati çdo deklaram që kemi pas, i ka hup kuptimi.Seanca është e inqizune dhe mundet me përcjell masanej,në mënyrë që procesverbalit të jetë ma komplet.

Kryesuesi - kërkoj nga ju që të jeni ma të ngadalshëm gjatë fjalimeve,në mënyrë që të merren shënimet më të sakta.

Alban Berisha - kur themelohen komisionet,në procesverbal zakonisht ceken vetëm propozimet e shefit të grupit.Kisha thanë që në procesverbal të shënohen emrat në fund se kush është zgjedh në atë komision.

Kryesuesi - e hedh në votim procesverbalin me vërejtjet që u thanë.

Miratohet me vërejtje

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-projekt vendimit për miratimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomikë Lokal;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - përshëndet të pranishmit. Ne si LDK përshëndesim çdo përpjekje e cila angazhohet për krijimin e një strategjie zhvillimore komunale. Deri tani për këto 4 vite kemi pas keqplanifikim, keqmenaxhim të parasë publike, investime pa kritere e cilësi të dobëta. Kjo qasje e kësaj qeverisje është apliku si mjet për arritjen e rezultateve elektorale. Kryetari aktual ka apliku këtë model qeverisje duke subvencionu portalet, të cilat shpërndajnë foto nga tryeza me punëtorë e foto me dush në dorë, me qëllim të krijimit të një imazhi pozitiv për veten e tij dhe në dëm të interesave qytetare. Strategjia për zhvillimin ekonomikë lokal që na është servu sot për shqyrtim e miratim është një dokument i cili në një formë e hedh posht angazhimin 4 vjeçar të qeverisjes aktuale. Për të qenë më konkret më lejoni të jap disa sqarime: Në këtë strategji parashihen investimet e mëdha në bujqësi. Ndërsa për 4 vite të kësaj qeverisje donacionet në bujqësi kanë qenë zero, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të drejtorisë së bujqësisë është përdorë për hapjen e rrugëve fushore.

Në këtë strategji konstatohet se 40 % e banorëve kanë qasje në ujësjellës ndërsa 45 % e banorëve janë të kyqur në sistemin e kanalizimit. Ndërsa kjo qeverisje për 4 vite mandat ka pas për strategji shtrirjen e rrugëve të oborreve e kualiteti i punimeve ka qenë si mos më keq. Në këtë strategji planifikohet të investohet në ndriçimin publik me panele solare. Ndërsa kjo qeverisje për 4 vjet ka bërë disa investime në ndriçimin publik, me kualitet të dobët të punimeve e duke pas probleme në secilin vendbanim. Në këtë strategji planifikohet të investohet në ndërtimin e liqenit artificial të Dragaqinës. Këtë ide je duke e trajtu çdo vit, e nuk je duke bërë asgjë konkrete. Sot unë po të ofroj gjithë mbështetjen e nevojshme nga ne, që kjo ide të ec përpara. Andaj leje propagandën por fillo të marrësh vendime konkrete për këtë qëshetje. Këto janë vetëm disa nga shumë fakte që dështmojnë, që për katër vite keni pas një qeverisje pa strategji, me investime pa kritere, kualitet i punimeve tejet i dëbët, keni pas keqplanifikim me keqmenaxhim të buxhetit, shkelje të vendimeve të Asamblesë komunale e rrjedhimisht shkeleje ligjore. Dhe për këtë thërras organet kompetente ligjzbatuese që të merren me hetimin e shkelejeve që keni adresu dhe jo vetëm.

Kjo strategji të paktën na ofron disa të dhëna statistikore për Komunën tonë, gjithëashtu gjatë leximit të saj vërehet një përpjekje për të kriju një orientim e një planifikimin të paktën pozitiv të investimeve publike, veqanërisht te disa sektore. Mirëpo përkundër një përpjekje për ta hartu një dokument i cili do të ndihmonte qeverisjen komunale për të ndryshuar qasjen e saj karshi interesit qytetar, ne mendojmë që kjo është e pa mjaftueshme dhe se kjo strategji duhet të plotësohet e të ripërgaditet. Gjithëashtu mendojmë që kjo startegji duhet të jetë e implementueshme dhe të bazohet në mundësitë reale që Komuna ka, dhe jo të planifikohen projekte të cilat nuk mund të implementohen. Si të tillë, ne e shohim si një vazhdimësi e një qeverisje me investime pa kritere që po vazhdon tash e katër vite dhe nuk mund ta mbështesim.

Dardan Berisha - përshëndet të pranishmit. Në parim ne jemi pro dhe mbështesim këtë nismë. Nëse rifreskohet kjo strategji, të jetë edhe sporti dhe ambienti si prioritet të kësaj strategjie.

Laureta Tafaj - përshëndet të pranishmit. Ne e përgëzojmë grupin punues. Jemi pro këtij vendimi dhe urojmë që mos të mbetet në të ardhmen në letër, por të zbatohet ashtu siç është.

Selman Kolgeci - sa i përket kësaj pike mendoj që, sido çoftë duhet përshëndetur puna e grupit të ekspertëve të angazhuar për përpilimin e draftit të strategjisë për zhvillim lokal.

Në këtë draft dokument është thënë se 21 vendbanime janë në rrjet të ujësjellësit. Ajo që mendoj që duhet të plotësohet në raport, është se duhet të dihet se sa banorë nuk kanë qasje në rrjetin e ujësjellësit. Dhe se cila është startegjia që qeverisja lokale do të furnizojë me ujë të gjithë banorët nëpër të gjitha lokalitetet, dhe cila është strategjia se si do të rriten kapacitetet furnizuese me ujë të pijes. Poashtu në këtë draft është potencu se 63 % e vendbanimeve nuk kanë fare rrjet të kanalizimeve, dhe shkarkimi i ujërave të zeza bëhet në forma klasike dhe në të shumten e rasteve derdhja bëhet direkt në lumenjë. Ndërsa si strategji për ti dal ballë kësaj gjendje po e shoh që është planifikuar ndërtimi i 30 mini impianteve për trajtimin e ujërave të zeza. Por mendoj që janë të pamjaftueshëm nëse fillimisht nuk trajtohet rrjeti i kanalizimit. Për këto arsye dhe shumë të tjera kërkoj që ky draft ti nënshtrohet plotësimeve të nevojshme dhe kur të jetë gati, ti silllet Kuvendit për miratim

Aziz Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Ne vlerësojmë angazhimin e këtij grupi për hartimin e kësaj strategjie dhe në emër të grupit e mbështesim këtë projekt-vendim.

Kryesuesi - e hedh në votim Pikën 2 me ndryshimin që e kërkoi asambleisti i PDK-së,që të ketë të dhëna më shumë për sportin në të ardhmen.

**20 Për ,9 kundër,
Miratohet Pika 2**

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2021,të komisionit komunal të aksionarëve të NPL“Stacioni i Autobusëve“ SH.A.;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë që për çdo sqarim është prezent kryeshefi i ekzekutivit të ndërmarrjes z.Halit Elshani. Kryesuesi hap debatin.

Liridon Fandaj - përshëndet të pranishmit.Unë në KPF e kam cek që kjo pikë nuk ban me ardh dhe me kalu në Kuvend kështu si është.Kjo nuk është një pasqyrë financiare por vetëm një përmbledhje e të hyrave dhe shpenzimeve.Kjo nuk i plotëson kushtet për një raport financiar.Edhe në raport nuk është fol për ndërmarrjen dhe për asetet që janë në këtë ndërmarrje por është fol për harmoninë në mes komisionit dhe bordit. Pra, nëse pasqyra financiare në fund është me minus dhe në raport shkruhet që nuk ka obligime kjo ndërmarrje.Nuk e di ku i kanë marrë këto pare që i kanë pagu.

Urim Suka - lidhur me raportin që na ka ardhë nga komisioni komunal i aksionarëve,ne e kemi diskutu kur është formu komisioni dhe i kemi paraqit shqetësimet tona.Ju jeni kanë ata që keni marrë obligime,që vet po doni mi dal n'ball edhe kompanive publike. -Sot ky komision na ka ofru ni „raport“ i cili është shumë i paqartë. Dua të di,sa meditje kanë marrë anëtarët e komisionit në këtë komision,dhe cili ka qenë kontributi i tyre për zhvillimin e kësaj ndërmarrje.Kërkojmë informata,se pse raporti i kësaj ndërmarrje ka dal minus,ku sipas disa informatave të mëhershme,zakonisht ka funksionu mirë.Dhe ne kemi kërkru edhe në KPF që ta kemi një raport të përpilum ma mirë,sepse në këtë formë që e keni pru,ne jemi kundër.

Bulëza Kuçi - përshëndetje për të gjithë.Shumica e mendimit tim u cek më lartë.Besoq që është e mundur që të na jepet një pasqyrë financiare pak më e detajuar.Vërejtjet e mija janë: të sqarohet ky minus 3 mijë euro ;sa takime i ka mbajt ky komision; në cilat shifra janë fut pagesat e komisionit;Gjithëashtu neni 3 thotë që,ky projekt-vendim është i përgaditur nga komisioni komunal,ndërsa ky raport shënon që është i përgaditur nga një zyrtar financiar.Kërkoj sqarime lidhur me këto.

Selman Kolgeci - duhet bashkangjitur në formë tabelare se cili ka qenë dëmi financiar që i ka shkaktuar kësaj ndërmarrje nga ky faktor? Si ka mundësi që ky problem ka ndodh gjatë gjithë vitit, ta dëmtoj buxhetin e ndërmarrjes dhe mos të ketë strategji se si të ndalet. Sa here e keni informuar drejtorinë e inspeksionit dhe a ka marrë hapa me qëllim të ndaljes së kësaj dukurie.A keni strategji se si kjo ndërmarrje do të funksionojë pa buxhet?

Kushtrim Kuçi - përshëndet të pranishmit.Pakënaqësinë e kam te përzgjedhja e anëtarëve të komisionit komunal.Vërejtaje, që gjatë gjithë kohës jeni bo si grup parlamentar dhe sa për të plotësu numrin e sa për tu arsyetu në Kuvned.Vërejtje kam edhe te anëtarët e bordit.Gjatë leximit të raportit, lexova raportet e mira që kanë anëtarët e bordit,mbledhjet e shpeshta me kryesuesin e Kuvnedit,Kryetarin e Komunës. Shqetësim i imi është,se në cilën gjendje gjindet stacioni i autobusave? Pyetje për anëtarët e komisionit Komunal: A keni bo kërkesë për investime në stacionin e autobusëve,Pyetje bordit të drejtorëve : a ka mundësi që nga të hyrat vetanake me bo diçka në këtë drejtim? Pyetje Kryetarit: a keni parapa diçka me investu Sepse vërtetë ka nevojë për investime stacioni i autobusëve.

Alban Berisha - te projekt-vendimi që është pike e rendit të ditës,a ka nevojë një raport me nxerr vendim për miratim,apo vetëm duhet me qenë si pikë e raportimit. Nuk e di pse duhet me marrë një vendim për raportin në fjalë. Nëse nuk e miratojmë raportin,cili është efekti juridik,ose nëse e miratojmë?

Mendoj që në raste tjera,raportimet mos mi bo projekt-vendime për me nxerr vendim.Por duhet ,me ni dokument normativ që kish ardh vendimi me miratu ni raport na si Asamble.

Kryesuesi - fton kryeshefin e stacionit të autobusëve z. Halit Elshanin për sqarime.

Halit Elshani - përshëndet të pranishmit.Elaboron dhe jep sqarime lidhur me raportin për vitin 2021 të komisionit komunal të aksionarëve të NPL”Stacioni i Autonusëve” SH.A.

Shefket Kolgeci - ku është arsyeja që keni shku me humbje? Menaxhimi i dobët i bordit, i komisionit të aksionerëve,apo ju si menaxher.Kërkoj arsyet. Sa mbledhje i ka mbajt komisioni dhe sa janë pagu?

Halit Elshani - te pyetja e parë, nga pandemia e deri më sot,ne kemi 4 trasa të qarkullimit të autobusëve,

por një trasë nga pandemia e këndej,pra Prizren-Suharekë dhe Prizren-Prishtinë dhe anasjelltas,hynë vetëm 7-8 operatorë nga 38.Që ne, humbjet ditore i kemi rreth 60 euro. Ndërsa bordi i drejtorëve i mban mbledhjet dy here në muaj.Bordi i drejtorëve për vitin 2021 ka marrë bruto 15 mijë euro.Te komisioni i aksionerëve të dalurat e pagave për vitin 2021 kanë qenë 2456.16 dhe janë mbajtë 14 mbledhje.

Liridon Fandaj - te pasqyra është vendos amortizimi.Amortizimi nuk është shpenzim.

Halit Elshani - është shpenzim sepse ndërmarrjes i zvogëlohen asetet.

Liridon Fandaj - ky nuk është raport.Duhet me pru bilancin e gjendjes, pasqyrën, rrjedhën e parasë dhe me na sqaru.

Halit Elshani - sipas standarteve të kontabilitetit,dje i kemi raportu dhe do ti sjell.

Liridon Fandaj - në mbledhje të KPF-së kam kërku që në këtë mbledhje me na ardh ni raoprt.Ju keni ardh veq me sqarime,dhe ne i dojmë pasqyrat financiare,me e pa gjendjen e ndërmarrjes si është.

Halit Elshani - propozoj që të formoni një komision,dhe mund të vini dhe ti shihni.

Urim Suka - ju falemderoj për sqarimet.Ne nuk kemi dyshime te puna juaj si staf.Ju mbështesim dhe do t'na keni mbështetje.Ne kërkum sqarime te meditet,te mbledhjet e komisionit.U tha që janë mbajtë 14 takime . Me vendimin që e keni miratu këtu në Asamble figuron që komisioni i aksionarëve ka të drejtë që të kompenzohen vetëm 6 seanca.

Selman Kolgeci - e potencut problematken e operatorëve ekonomikë të transportit të linjës Prizren-Suharekë-Prishtinë dhe anasjelltas që nuk po nalen këtu.Pyetja ime ishte:a e keni adresu këtë problematikë në drejtorinë e inspeksionit,dhe a ka ndërmarrë diçka? A keni strategji se si kjo ndërmarrje me funksionu pa buxhet?

Kryesuesi - Stacioni i Autobusit operon brenda oborrit të vet dhe jasht oborrit nuk ka kompetencë.Ka pas shumë raste kur ju kanë adresu inspeksionit ,dhe inspeksioni ka dal.Por gjithë kohën nuk kanë funksionu këto.

Selman Kolgeci - besoj që këto linja janë të evidentune në ministrinë e infrastruktures dhe marrin leje.Pse nuk e keni ndjek edhe ma tutje për këtë dam që i bëhet kësaj ndërmarrje?

Halit Elshani - te ne funksionon inspektori i komunikacionit por edhe ai republikan.Por inspektori republikan mbas pandemisë ka dal 2-3 herë,ndërsa inspektori i komunikacionit,edhe ky nuk del shpesh.

Mirëpo kur del rritet menjëherë numri i të hyrave.

Shefket Kolgeci - sigurisht vijat i kanë të regjistruara.P.sh. Prizren-Prishtinë dhe anasjelltas.Propozoj që të merret pagesa edhe për kthim.

Reshat Selimaj - jep sqarime rreth medetjeve dhe të hyrave.Nga 35 të hyra,26 gjatë ditës mungojnë.Atë ditë që del inspektori,krijohen të hyrat dhe në momentin që largohet bjen. Stacioni ka problem me statusin e pronës.Është në menaxhim të pylltarisë dhe kërkoj nga drejtori që ta shtyj këtë proces dhe ta zgjidhim statusin e ndërmarrjes.Sa i përket medetjeve,unë kam një vendim të vitit 2014 të ish anëtarëve të atëhershëm. Sikurse e kemi marrë ne tani,prej 24 e kemi kthy në 6. Ata e kanë marrë prej 6 apo hiq sika pas pagesa në atë kohë dhe e kanë bo me 24.Dhe ne ashtu e kemi vazhdu.

Kryesuesi - Albani kërkoi sqarime rreth raportit të vendimit.

Avni Byryqi - qështja e raportimit të Komisionit Komunal të Aksionarëve para anëtarëve të Kuvendit është e rregullune ekskluzivisht. Me vet faktin që ligji kërkon, që të raportoje komisioni komunal i aksionarëve para Kuvendit mbi performancën e ndërmarrjes publike lokale.Kjo nënkupton që ky raport duhet të miratohet nga ky Kuvend, për arsye që të konstatohet dhe të merret vendim që ndërmarrja publike lokale është duke vepruar dhe duke ushtruar detyrat e veta ashtu si e ka dhënë ligji dhe ashtu si e ka dhënë punën ky Kuvend.

Alban Berisha - unë prap e them që nuk na obligon me marrë vendim.Me gjithë respektin për z. Halitin,kërkojë me shumë përgjegjësi,që vitin e ardhshëm të raportoje komisioni i formuar nga Asambleja.

Avni Bytyqi - realisht raportet mbi performancën kërkojnë miratim nga eprori më i lartë.Në këtë rast eprori më i lartë në raport me komisionin që ju e keni delegu,jeni ju vet, Kuvendi. Ligji thotë: nëse vazhdimisht dy vitet e fundit,nuk kanë performancë të mirë financat e ndërmarrjes publike, ju duhet me marrë masa për shkarkimin e bordit të ndërmarrjes publike.

Alban Berisha - ne kemi pas raporte që sjan kanë në projekt-vendime dhe si kemi votu.Atëherë paskemi bo shkelje të ligjit edhe më herët.

Qëndrim Elshani - mora disa ankesa nga qytetarët që nuk ka transmetim direkt të mbledhjes. Kërkoj të shkojmë në pauzë deri sa të rregullohet,për shkak të transparencës.

Liridon Fandaj - kryesuesi i komisionit e potencoi që në stacionin e autobusave ka qera mbi qera.Pasi ka qenë anëtar i komisionit,a e ka ngrit këtë qështje?

Reshat Selimaj - unë e thash paraprakisht, edhe ish drejtori por edhe ky ,ka me kërkun prap që le ti verifikojnë.Unë them që kjo është e vërteta.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

**17 për,12 kundër,
Miratohet pika 3**

Pika 5. Shqyrtim i projekt-vendim për fillimin e nismës së procedurës për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - lidhur me këtë projekt-vendim,edhe në planet tona ka qenë që të kemi një ndërmarrje të tillë. Në emër të grupit do ti japim mbështetje kësaj nisme.

Dardan Berisha - ne si grup i asambleistëve të PDK-së e mbështesim këtë nismë.

Shefket Kolgeci - ndërmarrja eko-regjioni që ekziston,a ka diçka në bashkëpunim me këtë ndërmarrje apo do jetë ndërmarrje e re?

Kryetari - ne veq e kemi marrë nismën.Ka procedura dhe nuk vendosim ne.Është formu një ekip që është duke punu.Ju jeni dëshmitar që edhe më tutje skemi buxhet,dhe ka prishje të rrugëve,prishje të pusetave,humbje të pusetave ,dhe duhet me prit deri në qershor dhe nuk mundemi me punu.Pra kjo kompani ka mundësi me u marrë me këto,me deprim ma lehtë dhe mi kry punët.

Shefket Kolgeci - kam një shqetësim.Nëse kjo kompani do të merret në të ardhmen me mbledhjen e mbeturinave,çka do të bëhet në të ardhmen me këta punëtorë?

Kryetari - nuk është qëllimi me largu asnjë punëtor,por qëllimi është me shtu numrin dhe me mbledh të hyra më shumë.

Liridon Fandaj - edhe ne jemi pro themelimit të ndërmarrjes.Por para se me marrë këtë iniciativë,a janë plotësu kriteret e rregullores?

Avni Bytyqi - ne, pa e marrë vendimin prej këtij Kuvendi ,që e lejon një Kryetar komune që të fillojë procedurat,ne nuk mund të fillojmë as një hap pa e marrë pëlqimin paraprak nga ju.Në moment që e marrim pëlqimin paraprak nga ju,do të fillojmë me plotësimin e kushteve dhe kriterëve për themelimin e ndërmarrjes.

Shefket Kolgeci - këtë ndërmarrje ,a do ta menaxhojë komuna?

Avni Bytyqi - kjo ndërmarrje do të jetë 100% e Komunës.

Kryesuesi - e hedh në votim.

**26 për, 3 apstenime,
Miratohet pika 5**

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për hapjen e shqyrtimit publik të projekt-dokumentit „Harta Zonale e Komunës 2022-2030“;

Kryesuesi - e elaboron këtë pike dhe hap debatin.

Kushtrim Kuçi - sot ndihet shumë mirë meqenëse një dokument kaq i rëndësishëm siq është Harata Zonale më në fund Komuna arriti ta kompletojë për ta vendosur në dëgjim publik. Mingsesa e tij ka bërë që të ketë ndërtime nëpër lagje në formë të pakontrilluara.LDK çdo here e ka ditë rëndësinë e këtyre planeve.Procesi i PZHK-së 2021-2029 ka filluar nga LDK-ja në vitin 2017.Është e habitshme se pse u deshën 5 vite që të përmyllet si projekt.Si gr. i LDK-së jemi për aprovim dhe çdo here do ti përkrhim projektet e tilla madhore.Uroj që këtë plan ta përfundoni brenda 2 apo 3 muajve e ta sillni për aprovim.

Selman Kolgeci - Hartat Zonale është një dokument i rëndësishëm .Shqetësimi im është stërzgatja e arritjes së këtij dokumenti.Kërkoj që ta prezantoni një plan detal të debateve publike dhe të na tregoni saktë dhe drejt se si do të informohen edhe fshatrat e thella me atë se çka është planifuku të bëhet me dhe pronat e tyre.Është me rëndësi që ky plan të diskutohet me grupet e interesit e të përfaqësojë interesat e qytetarëve.

Sanie Kuçi Rexhepaj - përshëndet të pranishmit.Ky dokument realisht ka fillu që të hartohet në vitin 2018,në fazën sa kam qenë Drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim.Ky dokument,që realisht është i pari i nivelit të tillë që po hartohet në Komunën tone,ka kaluar një proces të gjatë duke i ndjekur të gjitha hapat dhe rrugët ligjore konform dispozitave ligjore në fuqi.Sot para jush kam dy kërkesa.Kërkesa e pare është ,që ju ftoj të jeni pjesë e e procesit. Propozoj që ky vendim të miratohet dhe secili prej jush të jeni pjesë e procesit duke ftu sa më shumë qytetarë,që të jenë pjesë e diskutimit dhe shqyrtimit 30 ditor,dhe të njejtën kohë me qenë prezent në diskutim publik.Gjithëashtu propozoj që të formohet një ekip nga ana e Kuvendit me përfaqësues të ndryshëm të partive politike,çoftë të jemi vendimmarrës,çoftë të jemi në formën e

vëzhgimit në fazën e shqyrtimit të të gjitha kërkesave të qytetarëve. Kërkesa e dytë ndërlidhet me drejtorinë e Urbanizmit ,dhe kërkoj që Hartat Zonale të jetë në përpuethshmëri të plotë me Planin Zhvillimor Komunal dhe të gjitha kërkesat të cilat janë miratu në fazën e shqyrtimit publik të PZHK-së.të jenë të azhurune edhe në Hartat Zonale të Komunës.

Selman Kolgeci - thatë që keni plan të debateve,në sa zona janë të ndane ?

Sanie Kuçi Rexhepaj - kjo është pjesë e drejtorisë rreth hapjes së diskutimit. Di që 30 ditë ka me zgjat. Dua të shtoj që,te pjesa tekstuale e dokumentit është një tabelë e cila tergon kush janë kontribuesit që kanë kontribu në hartim të këtij plani dhe quditërisht pashë që disa emra,përfshirë edhe veten e që kemi kontribu 2-3 vjet janë largu nga ajo listë.Janë disa kontribusë dhe është mire me u përfshi,qoftë edhe nëse ne e kemi përfundu mandatin.

Festë Kabashi - përshëndet të pranishmit.Përgëzoj ish drejtoreshën e Urbanizmit për dy kërkesat e saj.Ne si grup parlamentar e konsiderojmë tejet të domosdoshme shqyrtimin publik të projekt-dokumentit të Haratave Zonale dhe në parim padyshim do ta mbështesim.Por kërkojmë nga ju që kërkesat e qytetarëve në dëgjim, të merren për bazë dhe të trajtohen me seriozitet maksimal. Nga praktikat e mëhershme kemi ankesa nga qytetarët,që dëgjimet publike janë mbajt në mënyrë sipërfaqësore. Ftoj të gjithë qytetarët që të marrin pjesë në dëgjim publik.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-dhjetor 2021;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - të dashur qytetarë.Këtë projekt-vendim për miratim të llogarisë përfundimtare të vitit 2021 e ka sjell kjo qeverisje dhe në fletën e pare të tij shkruan:teprica e të hyrave ndaj të dalurave është 1142111 euro.Fjalën time do ta vazhdoj me tri deklarime të Kryetarit Muharremaj.E para:gjatë fushatës së vitit 2021 ai premtonte se në mandatin tone nuk ka me ndodh për katër vjet asnjëherë që me shku buxheti i qytetarëve të Therandës në suficit.Në fushatën e vitit 2021 ai delkaroi se viti i pare,i dytë dhe i tretë kanë mbet suficit nga 70 mijë euro.Dhe e trta:në seancen e kaluar të Asamblesë deklaroi që bartje ka por suficit nuk ka.

Vetëm për dy vitet e fundit ky Kryetar i ka dërguar në suficit 530425 euro. Deklarimet e Kryetarit rreth 50 milionëshit,që e proklamoi gjithëandëj e të cilin e ngriti edhe në mbledhjen e kaluar,e në disa raste edhe në takime joformale me qytetarë.Pra për katër vjet qeverisje Muharremaj, nga grandit qeveritar,nga të hyrat vetanake,nga huamarrjet dhe donacionet janë investu për investime kapitale 21 milion euro. Ne si LDK nuk mund ta mbështesim një raport të tillë financiar dhe angazhohemi për mbikqyrjen e secilit projekt e secilës kontartë me qëllim të mbrojtjes së ligjshmërisë dhe interesit qytetar.

Qëndrim Elshani - nga shpenzimet sipas programeve shihet qartë se shfrytëzimi i buxhetit në maksimum është nga zyra e Kryetarit me 99.86 %,do thotë që i gjithë buxheti i alokum është shpenzu.Ndoshta arsyeja është se ka qenë vit zgjedhor.Drejtorja e bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural,bugjetin janar-dhjetor 2021e ka shfrytëzu 87.64 %,ku bie në sy që te kategoria e shpenzimeve kapitale nga të hyrat vetanake të alokuara në vlerë prej 67800 euro,janë shpenzu vetëm 35960 euro.Duke marrë parasysh bujqësinë në Komunën tone që mun me sjell zhvillim,a nuk ka qenë e mundur që ky buxhet të shpenzohet dhe të rregullohet infrastruktura rrugore për bujqit,apo do vazhdojmë gjithmonë me bartjen e mjeteve nga viti në vit në këtë kategori? I njejtë avaz ka vazhdu edhe te drejtorja për rini kulture dhe sport,ku buxheti

është shfrytëzuar vetëm 35.66%. Te kategoria për “ dreka zyrtare” të Kryetarit dhe drejtorëve të tij ka qenë 20740 euro.Dhe nëse kësaj shume ia shtojmë edhe “furnizim me ushqim e pije”,atëherë kjo shumë trefishohet,dhe tash është shumë.

Kryesuesi - e hedh në votim.

15 për, 13 kundër Miratohet pika 7

Pika 8. Pyetje dhe përgjigje;

Kryesuesi - hap debatin.

Kryetari - në dreka zyrtare nuk shkoj kurrë unë personalisht. A din asambleisti i LDK-së me bo dallimin në mes të hyrave vetanake dhe grandeve dhe suficitit.Shumë procedura kanë mbet pa u kry. E dini që lëndët janë në OSHP dhe me çfarë qëllimi kanë shku,dhe ku janë këto pare,ku kanë shku. Për katër vite kanë qenë mbi 10 milion euro donacion. Të hyrat janë rrit vitin e kaluar.Ato që i kam thënë, i kam arritë.Kërkoj bashkëpunim,dhe kur ka nevojë për kritika i pranojmë.Te harta zonale do të vazhdojmë me punu sikur te plani zhvillimor,që i kemi ftu të gjithë asmleistët.

Urim Suka- këtu nuk ke punë me Sukën por me qytetarët e Suharekës.I numërova krejt ato që janë në letër ,vendime të miratume në Kuvend.Dhe në anën tjetër ti po vazhdon me këmbngul te suficiti,kur vet keni thënë që s'ka suficit por ka bartje.Pse nuk i llogaritni edhe projektet tona të qeverisë,edhe donacionet.Neve po na llogarit vetëm ato çka kemi investu nga buxheti. Ideja është me manipul.

Kryetari - unë kam manipul me 17 -in, me 51 %.

Aziz Bytyqi - bëhen debate që do të duhen të bëhen brenda forumeve politike.Unë e kuptoj tendencën,për me nxjerr një arsyetim për diçka tjetër !Por këto janë qështje të mbrendshme të subjekteve politike.Nuk më duket e arsyeshme Kuvendi mu përdor për këtë.

Urim Suka - unë fjalën time që e pata me Kryetarin, e pata me shifra konkrete e fjalë konkrete që ky ka premtu.Unë s'bona asnjë politikë të brendhme as të jashtme,por shefi ju u muni me bo politikë.

Aziz Bytyqi - për hir të vërtetës qytetari ka fol me 17 tetor.

Shefket Kolgeci - e kam obligim prej bizneseve,që më kanë autorizuar.Qështja e taksës komunale është një vendim jo i mirë.Propozimi prej bizneseve është që taksat të hiqet.Edhe në emër të grupit,nëse s'jeni të gatshëm e shtym për mbledhjen tjetër me një pikë të veçantë në rend dite për heqjen e taksave. Në vitin 2020,në kohën e pandemisë e kemi hekur 50 % të taksës komunale,dhe kërkoj të di nga drejtori, që ,a është hequr atëherë kur kemi marrë vendim ?

Kryesuesi - ka qenë e përkohshme.

Shefket Kolgeci - në emër të bizneseve por edhe në emër të grupit, kërkoj që mbledhjen e ardhshme të jetë si pikë e veçantë në rend dite,të diskutohet dhe të analizohet,por edhe të mirret vendim.Kërkesa tjetër është për drejtorinë e shërbimeve publike.Kanalizimi në Vraniq nuk funksionon dhe është mbyll.A është bo pranimi teknik i atij kanalizimi dhe kush ka qenë mbikqyrësi i atij projekti? Kërkoj që të formohet një komision nga Asambleja.

Enver Shabani - përshëndet të pranishmit.Kanalizimi në Vraniq u zhagit shumë,por ka një pranim teknik.E kemi thirr kompaninë dhe kompania e ka bo sanimin e kanalizimit.

Kryetari - jep sqarime shtesë lidhur me pyetjen.

Dardan Berisha - ankesa e qytetarëve është te rruga „Ibrahim Lutfiu“,për pastrimin e terrenit, konkretisht në parcelën e Kishës.

Kryetari - ne do të fillojmë me një aksion të madh,në çdo fshat dhe ju ftoj të gjithëve kush ka mundësi të dilni.

Laureta Tafaj - kryesues,e keni marrë një kërkesë nga Festa Kabashi,rreth tre javë më parë për plotësim ndryshim për tërheqje nga komisioni për konvertim në pronë.

Avni Bytyqi - po,kërkesa ka ardhë dhe do të jetë mbledhjen e radhës plotësim ndryshimi.

Laureta Tafaj - duke e ditë që qeveria e Kosovës ka vendos që vitin 2022 ta shpall vit të personave me aftësi të kufizuara,ne dëshirojmë të informohemi se qfarë ka bërë komuna jonë për këtë kategori. -Cilat aktivitete janë bërë der tash në komunën tonë ?-A po punohet ngusht me personat me aftësi të kufizuara dhe me shoqatat që ofrojnë shërbime për ta ? – A ka një data bazë se sa persona me aftësi të kufizuara

janë në komunën tonë ? Ju lutem që ne të gjithë së bashku, të bëjmë më shumë për ta, duke filluar me ofrimin e një qendre ditore.

Kryetari - përmes Asamblesë ndahen dikun 35000 ose 40000 për personat me aftësi të kufizuara. Falemnderoj kompaninë nga Dubrava që është duke ndërto objekte të reja për personat me aftësi të kufizuara. Plani jonë është, që në qoftëse kalojmë këtë vit të qerdhja e re, atëherë e qesim në Asamble që qerdhja e vjetër të kalojë në shfrytëzim të personave me aftësi të kufizuara.

Laureta Tafaj - a do të jetë një plan B nëse ajo nuk mundet me funksionin? Dhe a kishim mujt Kryetar me shku së bashku me vizitën një qendër në Prishtinë dhe me marrë si model.

Kryetari - jep përgjigje.

Qëndrim Elshani - gjatë kësaj kohe kam marrë ankesa prej qytetarëve që nuk po mund të përcjellin bledhjet për shkak të rezulcionit të dobët, që herë punon e herë jo. Pasi nuk keni lidh kontratë me asnjë media për transmetimin e mbledhjeve të Kuvendit, besoj që do të kishte qenë mirë që kamerat në sallë të jenë të vendosura në të gjitha pozicionet. Kam dhe një qeshtje dhe vi me kërkesën e banorëve të fshatit Nishor: Në rrugën Brahaj është një zonë, si kodra e asaj lagje, ku në të kaluarën kanë marrë nga aty gurë dhe rrasa. Këto zona trgojnë rrezik të madh për qytetarët e asaj zone, përkatësisht fëmijët. Ju lus të merren masa konkrete.

Flamur Bytyqi - po flas për fshatin Semetisht. Është rregullu sanimi i gropave në lokacion para zgjedhjeve, e tash pas 6 muajve pothuaj gjendja e rrugës është e njejtë. Jeni zotuar për zgjerimin e rrugës kryesore që lidh fshatin Semetisht dhe Peqan i Vogël, dhe kurrë nuk keni nda mjete për këtë rrugë. Është premtuar që ka me pas dy herë në javë mjek në ambolant dhe motër medicinale me orar të plotë, por aty nuk ka as mjek dhe as motër medicinale. Në fshatin Gelancë, që katër vite në rrugën Qadraku, janë në sipërfaqe ujërat e zeza nga lagja e U. Qerimit. A keni planifikuar me zgjidh problem për këtë? Që për këtë problem, banorët e lagjes Qadraku kanë investime vetanake, dhe ju po tentoni mu lidh me të njejtin kanalizim.

Kryetari - nuk është e vërtetë që rruga është rregullu gjatë fushatës. Është e vërtetë kërkesa për zgjerimin e rrugës. Në Gelancë është problemi lagje me lagje dhe jemi duke u mundu me rregullu, që me u marrë vesh.

Besa Kuçi - përshëndet të pranishmit. AMF Nishori ka mbi një vjet që ka doktor. Ka doktor me orarin e pasditës, kurse paradite është infermierja. Mundet me ndodh që ka mungesë të doktorit në atë orar, për shkak që në momentin mjeku në QMF apo QKMF merr pushim ose për shkaqe tjera të arsyeshme nuk mund me qen, atëherë detyrohemi të bëjmë zvendësimin.

Flamur Bytyqi - për punën e shujtave, në mbledhjen e kaluar pyetja ime ishte, se a jeni konsultuar me institucionet përgjegjëse, dhe Kryetari ka thënë po. Unë kam vendimin e ministrisë së financave i cili konstaton që vendimi për pagesën e shujtave është i pa ligjshëm.

Selman Kolgeci - çka po ndodh me projektin për vendosjen e panelave ndriçues mbi vendkalimet e këmbësorëve? Jemi dëshmitarë dhe kemi parë me sytë tanë se si ato panela po bien në tokë si pasojë e një pune jo profesionale, e si rrjedhojë duke rrezikuar kalimtarët. Kërkoj sqarim se pse këto panele nuk po e kryejnë funksionin për të cilin janë vendosur?

Enver Shabani - nuk ka qenë një projekt që e kam menaxhu unë. Ma shumë ka qenë një lloj donacioni i cili ka pas menaxher tjetër, koordinator tjetër. Fajin kryesor e kanë operatorët ekonomikë që po bëjnë punë të dobëta.

Selman Kolgeci - është e vërtetë që është donacion, mirëpo procedurat e tenderimit dhe kontratën, operatori ekonomikë e ka lidh me komunën e Suharekës. Cilat hapa i keni marrë?

Enver Shabani - mos e merrni personale. E pata fjalën për operatorin ekonomikë që e ka kry atë punë, i cili i ka vënë shtrëngesat e dobëta.

Selman Kolgeci - a ka mundësi me i marrë dhe me i heq krejt sepse janë rrezik për qytetarët.

Enver Shabani - jep përgjigje.

Alban Berisha - puna e ndriçimit në qytet nuk është stabile. Në shumë pjesë të Suharekës ka problem, duke pas parasysh edhe faktin e qenëve endacak. Ka puseta që po i vjedhin kapakët. A keni bënë na një task forcë që mundet mi mbykqyr këto? Ju përgëzoj për rrugën e Reqanit që e keni zgjidh problemin e ujit. Ne si pjesë e qytetit, rruga Bedri Pejani, kemi problem me kanalizim. A mund ta keni parasysh këtë.

Enver Shabani - jep përgjigje.

Urim Suka - Dua të di për fatin e rrugëve të vitit 2021 në fshatin Mushtisht, të cilat kanë qenë të planifikuara por për shkak të ankesave në OSHP këto rrugë nuk janë shtruar të gjitha. Habitem se si keni

shtru dy rrugë edhe pse kanë pas ankesë në OSHP. Ku i keni marrë mjetet për këto dy rrugë dhe për dy rrugë të tjera, që janë rruga Riza Demiri dhe seg. i rrugës Nezir Shala që nuk kanë qenë në planifikim e që janë shtru. Qytetarët e Bllacës kanë ankesa për shkak të hapsirave për varreza. Për këtë qështje është nda një parcelë dhe qysh atëherë nuk është bo asnjë investim. A keni planifiku ndonjë zgjidhje për këtë dhe nëse ska planifiku, a mund të bëhet diçka në këtë drejtim? Te këshillat lokale, ekziston një rregullore në kuadër të Komunës, dhe kjo rregullore parasheh që mu formu një komision nga Kuvendi Komunal për mi parapa zgjedhjet. Është e rëndësishme që në çdo vendbanim me u formu këshillat lokal.

Kryesuesi - në seancën e radhës, kemi me pas një pikë për formimin e komisionit që do të mirret me formimin e këshillave lokale.

Enver Shabani - edhe në Mushtisht lënda e prokurimit ka shku në OSHP. Operatori ka hy me 60 % të mjeteve dhe 40 mijë euro janë mbetje, dhe në zonën e prokurimit kemi fut fazën e dytë se na ka leju ligji, me parat e mbetjes. Shumicën e rasteve kemi kemi vendos me kryesitë e fshatrave, që në fazën e dytë, shumica e rrugëve ka shku në bashkëpunim me kryesitë e fshatrave.

Urim Suka - dy rrugë të tjera janë shtru që skanë qenë në planifikim, dhe disa rrugë që kanë shku në OSHP nuk i keni shtru. Me çfarë kriteri?

Enver Shabani - këto dy rrugët që janë shtru, janë shtru me mbetjet e Mushtishtit.

Urim Suka - a ka pas ankesa?

Enver Shabani - nuk është anku për emra por për diçka tjetër. Për varrezat, ne si drejtori nuk bëjmë hapsira për varreza, por nëse eventualisht kalon në Asamble ose pronë, atëherë ne i menagjojmë kohë pas kohe, kryesisht në qytet dhe eventualisht nese paraqitet naj rast i rëndë në fshat dhe bëjmë pastrimin e varrezave, por nuk mirremi me hapsira.

Urim Suka - kjo që e ngrita a merret si kërkesë?

Enver Shabani - kur të vje buxheti, ju mundeni me fut si pikë shtesë, nese të aprovohet.

Avni Bytyqi - është e vërtetë që Kuvendi e ka nda parcelën, mirëpo ndoshta është neglizhencë e shërbimeve pronësore juridike që nuk ka dal me bo parcelizimin e parcelës ku është nda nga ky kuvend.

Liridon Fandaj - në fshatin Peqan, rrugët Emërllah Hoxha dhe Kolonja janë të shtrune. Si ka mundësi që janë të planifikuara për vitin 2022?

Enver Shabani - jep sqarime rreth kësaj pyetje.

Selman Kolgeci - shumë njerëz janë në përgjegjësi, janë prapa grilave dhe kjo është shkelje ligjore. Ju rekomandoj mos me bo një gjë të tillë. Përpos që jeni duke e anashkalu vendimin e Asamblesë për ndarje buxhetore, jeni duke bo edhe shkelje ligjore.

Takimi përfundoi : 12 :40

Procesmbajtësja :
Dafina Haziraj